

## **AKT – THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **“VRETO CONSTRUCTION” sh.p.k.**

Sot ne daten **22.01.2024**, un ortaku themelues :

**Z. Agron Vreta** shtetas shqiptar, i datelindjes **20.06.1979**, atesia Astrit, lindur ne Farret, banues ne Durres, i pajisur me karte identiteti ID **033754876** me nr personal **H90620051Q**, leshuar me date **22.10.2018**, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **“VRETO CONSTRUCTION” sh.p.k.**

#### **NENI 1**

##### **EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria do te quhet **“VRETO CONSTRUCTION”sh.p.k** dhe eshte person juridik shqiptar

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901,date 14.04.2008.

#### **NENI 2**

##### **SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete seline e saj ne:

**Durres Lagjja 17, Rruga Deshmoret, Zona Kadastrale 8513, me nr. pasurie 5/443-N2.**

Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

#### **NENI 3**

##### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj :

**Ndertim banesash dhe objektesh te ndryshme dhe rikonstruksione. Ndertim dhe shtrim rrugesh, ndertim urash dhe vepra arti. Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndryshme te ndertimit dhe inerte, mermer e granit, me shumicë e pakicë, import - eksport. Prodhim e tregtim pllaka per shtrim, me shumicë e pakicë, import - eksport. Tregtim me shumicë e pakicë dhe import - eksport të: Makinerive e pajisjeve te ndryshme, mjeteve te ndryshme te transportit, mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, hidrosanitare, hidraulike, kanceleri per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, pajisje elektrike e elektronike, elektroshtepiake, pjese kembimi, per automjete, punime duralumini etj. Tregti me pakice karburanti dhe gazi. Bar-Restaurant, Lavazh. Sherbime te ndryshme financiare. Pike servisi automjetesh. Restaurant, Hoteleri - Turizem. Transport pasagjeresh dhe mallrash te ndryshme, brenda dhe jashte vendit.**

**NENI 4**

**KAPITALI I SHOQERISE**

**Kapitali i shoqerise “VRETO CONSTRUCTION” sh.p.k eshte 100.000 (njqindmije) leke Ky kapital perbehet nga 1 kuota dhe zoterohet nga :**

- 1. Z. Agron Vreta qe zoteron 100 % te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren 100.000 leke.**

**NENI 5**

**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj ne QKB.

**NENI 6**

**ORGANET E SHOQERISE**

- Asambleja e pergjithshme e Ortakeve- Organi me i larte vendimarrës;
- Administratoret- organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqerise.

**ASAMBLEJA E PERGJTHSHME**

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e Statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesave dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likujduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga aministratoret,perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

-Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti

#### **ADMINISTRATORET**

**Administrator i shoqerise do te jete Z. Agron Vreta, shtetas shqiptar , i datelindjes 20.06.1979, atesia Astrit, lindur ne Farret, banues ne Durres, i pajisur me karte identiteti 033754876 me nr personal H90620051Q, leshuar me date 22.10.2018,i cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte riperteritje.**

Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment nga asambleja, me shumice te thjeshte te votave, me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

#### **NENI 7**

##### **SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE**

Pjesa e fitimit qe i takon seicilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruarne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

#### **NENI 8**

Ortaku themelues mund te vendosi me vullnetin e tij, per pjesemarrjen ne Shoqeri te tjera dhe mund te krijojte cdo lloj aktiviteti tjetër privat, me perjashtim te kufizimeve te percaktuara me ligj.

#### **NENI 9**

Organizimi dhe funksionimi i shoqerise, ngritja e degeve apo filialeve te saj do te behet ne perputhje me dispozitat e ligjit perkates dhe statutit.

#### **NENI 10**

Ortaku detyrohet te ruaje sekretin e themelimit dhe te veprimtarise se Shoqerise. Te punesuarit dhe te ngarkuarit me drejtimin e Shoqerise mbajne pergjegjesi dhe detyrohen te zhdemtojne Shoqerine per demet qe i jane shkaktuar per faj te tyre gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre.



**NENI 11**

**Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët e Shoqerise. Cdo gje qe nuk eshte parashikuar ne statut do te disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore ne fuqi.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**“VRETO CONSTRUCTION” sh.p.k.**

**AGRON VRETA**

*Agrom Vreta*